

## ANALIZA VJETORE E MTKRS

### Veprimtaria dhe arritjet e realizuara gjatë vitit 2011

#### 1. NË FUSHËN E TURIZMIT

- Gjatë vitit 2011 Shqipëria është vlerësuar nga Guida turistike ndërkombëtare LONELY PLANET në listën e 10 vendeve më të mira për t'u vizituar gjatë vitit 2011. Klasifikimi i 10 vendeve është bazuar në potencialet turistike, nivelin e argëtimit, koston e pushimeve, mikpritjen etj.
- Gjatë vitit 2011, Shqipëria ka marrë pjesë në 9 panairë ndërkombëtare turistike, krahasuar me 6 në vitin 2010.
- Për vitin 2011 kanë hyrë gjithsej **4 milion e 1 mijë vizitorë** të ndarë në :
  - a. 2 milion e 734 mijë vizitorë jorezidentë me nënshtetësi të huaj
  - b. 1 milion e 267 mijë vizitorë jorezidentë me nënshtetësi shqiptare
  - c. Numri i vizitorëve me nënshtetësi të huaj është rritur 18.7% ,në krahasim me një vit më parë ose kanë hyrë më shumë se 430 751 vizitorë në krahasim me 2010.
  - d. Numri i vizitorëve në parqet arkeologjike gjatë vitit 2011 është 372 926.
- Ka filluar nga zbatimi projekti i financuar nga UNDP për realizimin e një *Studimi Fizibiliteti për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në zonën Durrës Plepa – Përroi i Agait* (shkëmbi i Kavajes).
- Në kuadër të projektit “*Promovimi i turizmit të qëndrueshëm dhe mjedisit në rajonin e Kukësit*“ implementuar nga UNDP janë realizuar ndërhyrje për rehabilitimin e infrastrukturës turistike në rrethin e Kukësit, është hapur Zyra e informacionit turistik dhe janë vendosur sinjalistika turistike, është ndertuar kampingu në Valbonë etj.
- Nënshkrimi i protokollit të bashkëpunimit ekonomik më Turqinë
- Marrëveshjet në fushën e turizmit me **Kinën**, në kulturë dhe turizëm me **Katarin**, me **Vatikanin**, me **Rusinë**,

## 2. NË FUSHËN E TRASHËGIMISË KULTURORE

- Është realizuar rikonstrukcioni i rrugës pedonale në Shkodër me një **investim prej 30 mln lekë**
- Është realizuar blerja e një godine të re për **Fototekën Marubi** në rrugën pedonale, një nga atraksionet e qytetit të Shkodrës me akses të konsiderueshëm nga publiku dhe vizitorët.
- Ka përfunduar faza 1 e projektit “**Zhvillim i qëndrueshëm dhe integral i qendrave të trashëgimisë historike**” me financim i **Komisionit Evropian**, Programi CARDS 2006 me vlerën **3,148,262 Euro** ku janë përfshirë **rehabilitimi i Siteve historike: Kalaja e Tiranës rikonstrukcion i rrugës Murat Toptani, Kalaja e Krujës dhe Kalaja e Himarës.**
- Kanë nisur zbatimi i fazës së dytë i këtij projekti (Programi IPA 2009) me vlerën **3,148,262 Euro** me rehabilitimin e **Siteve historike të Shkodrës Rruga "Kardinal Koliqi", Elbasanit Rruga “ Egnatia”, të Korçës "Pazari i Vjetër , të Beratit, Kalaja.**
- U rihap pas 20 vjetësh Muzeu Arkeologjik Apoloni me financim të UNDP-UNESCO.
- Është ngritur e **pavioni muzeor i genocidit komunist** përmes një financimi nga buxheti i shtetit në vlerën 5.2 milion lekë në Muzeun Historik Kombëtar.
- **Jane Miratuar projektet per rijetezimin e kalase se Lezhes dhe te Ndroqit te cilat do te mbesh teten dhe zbatohen plotesisht nga siper marrje private.**
- Është hartuar Plani Kombëtar i Veprimit për luftën kundër trafikimit të veprave të artit (dokumenti është në fazën e miratimit në Këshillin e Ministrave)
- Është hartuar për herë të parë nga një grup pune kartela shkencore tip për trashëgiminë shpirtërore dhe janë përcaktuar zërat e ndryshëm të regjistrimit për të gjitha zhanret

### 3. NË FUSHËN E ARTIT DHE KULTURËS

#### A. ARTI

- Është krijuar dhe funksionon institucioni qëndror publik i Teatrit Kombëtar të Komedisë.
- Është përmirësuar infrastruktura e institucioneve të artit dhe kultures, si rikonstruksioni i plote i Teatrit të Kukullave dhe rikonstruksioni i pjesshëm i Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor. Galeria Kombëtare e Arteve, Teatri Kombëtar.
- Në kuadër të veprimtarive kulturore dhe përkujtimore MTKRS ka mbështetur dhe promovuar një sërë aktivitetesh nga të cilat më të spikaturat janë:
  - **At Gjergj Fishta – në 140 vjetorin e lindjes**
  - **Marie Kraja – në 100 vjetorin e lindjes**
  - **Migjeni — në 100 vjetorin e lindjes arti**
- **Fondi Publik për të Rinjte:**
  - Fondi Publik i të Rinjve në TKOBAP” – Muzikë, Balet dhe Ansambël Popullor (40 artistë të rinj të angazhuar përgjatë gjithë vitit në produksionet e TKOBAP me vlerën prej 7.500.000 lekë )
  - “Festivali Teatror i të Rinjve” – Teatër (mbi 60 artistëve të rinj të regjisë, skenografisë, kostumografisë dhe aktrimit debutuan krijimet e tyre në skenën e TK, përgjatë vitit 2011 me vlerën prej 3.963.000 lekë )
  - Fondi për Aktorët e Rinj të Teatrit Kombëtar për Fëmijë me vlerën 3.390.000 lekë
  - Fondi për Artistët e rinj në artin pamor - 6 artistë të rinj të atashuar pranë Galerisë Kombëtare të Arteve në cilësinë e kuratorëve dhe koordinatorëve të aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare më të rëndësishme vjetore ( 1.008.00 lekë)
- Në fund të vitit 2011 në kuadër të çeljes së veprimtarive festive për **100-Vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë (28 nëntor 2011- 28 nëntor 2012) janë shpallur dy konkurse :**
  - konkursi me karakter kombëtar ( për realizimin e logos me temën e Pavarësisë së Shqipërisë e cila do të shoqërojë të gjithë komunikimet zyrtare ) dhe
  - konkursi me karakter ndërkombëtar ( për realizimin e Monumentit të Pavarësisë e cila do të vendoset në një nga hapësirat publike të qytetit të Tiranës më 28 nëntor 2012)

- Me nënshkrimin më datë 20 dhjetor 2011 të *Memorandumit të Mirëkuptimit mes Qeverisë Shqiptare dhe Komisionit Evropian për programin për kulturën të BE-së*, “Kultura 2007-2013”, të gjitha institucionet kulturore shqiptare do të mund të aksesojnë fonde të BE-së në fushën e artit, kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore.

## **B. LIBRIT DHE BIBLIOTEKAVE**

### ***a. Mbështetje për Botimet :***

- Në kuadër të dënimeve të krimeve të komunizmit, gjatë vitit 2011 u financua botimi i veprës studimore “Masakra e Tivarit” e autorit Uran Butka, veprës “*Rrugët e ferrit të çarë*”, të autorit Visar Zhiti, si edhe u realizua promovimi i librit “*Gjysëm shekulli genocid në Shqipëri*” të studiuesit Tomor Aliko.
- Mbështetje financiare për pjesëmarrjen e një grupi shkrimtarësh dhe botuesish shqiptarë në “*Panairin e Ndërkombëtar të Librit Lejzëg 2011*”, i konsideruar si panairi më i madh në botë për shkrimtarët.

#### 4. FUSHA E RINISË DHE SPORTEVE

##### a. Sporti

- MTKRS ka mbështetur aktivitetet kualifikuese për **Lojërat Olimpikë Londër 2012** dhe deri tani është siguruar pjesëmarrja **me ekipin olimpik me te madh ndonjëherë me rreth 14 kandidatura.**
- Është përsosur më tej infrastruktura sportive në disa objekte sportive si në **stadiumin e Korçës në shumën prej 1 200 000 Euro**; Pallatin e Sportit në Bajram Curri **(në shumë në prej 90 000 000 Lekë)**; dhe Stadiumi i Beratit **(në shumën prej 50 000 000 Lekë)**.
- Ne Shqipëri janë zhvilluar disa aktivitete sportive të **kuadrit botëror** si:
  - Kampionati Botëror i Vrapimit Malor, ku morën pjesë 550 sportistë nga 5 kontinentet e Botës,
  - Kampionati Botëror i Mundjes për Veteranë me pjesëmarrjen e 400 sportistë nga 24 vende të botës,
  - Finalja e Kampionatit Botëror të Shahut për Femra, Nëntor 2011
- Për here të parë në Shqipëri me një investim 100 % të MTKRS u hap **“Qendra Kombetare e Kontrollit Mjekësor dhe Antidoping, në perputhje të plote dhe bashkepunim me WADA.**
- Gjate këtij viti, paraqitja në aktivitetet sportive ndërkombëtare të sportistëve shqiptarë, është bërë më dinjitoze **duke marrë 2 medalje ari, 6 argjendi dhe 5 bronxi**, në sporte si mundje, peshëngritje , judo.

## **OBJEKTIVAT PËR VITIN 2012**

### **5. NË FUSHËN E TURIZMIT**

#### *Në fushën legislative*

- Miratimi i ligjit të ri “*Për turizmin*” dhe përgatitja e akteve nënligjore në zbatim të tij. Ligji parashikohet të nxisë, lehtësojë e orjentojë :
  - *investimet private në këtë sektor,*
  - *instrumentat per planifikimin e zhvillimit te turizmit*
  - *forcimin e partneritetit me sektorin privat,*
- Do te fillojme hartimin e planit kombetar per zhvillimin e turizmit si dhe percaktimin e zonave me perparesi per zhvillimin e turizmit duke krijuar kushte me te sigurta per zhvillimet private ne kete sektor si dhe duke rritur vleren e prones publike dhe private.
- Ne bashkepunim me qeverisjen vendore do te identifikojë dhe promovojë itinerare te reja turistike te cilat do te shfrytëzojnë burime turistike deri tani te fjetura.

### **6. NË FUSHËN E TRASHËGIMISË KULTURORE**

#### **Muzete**

- **Kemi nevojë të rrisim ndjeshëm numrin e muzeve në Shqipëri për dy qëllime:**
  - Per qëllime edukative si tempuj te historise dhe kujteses kombetare
  - Si burime te rendesishme turistike qe gjenerojne te ardhura dhe rrisin kohen e qendrimit te turistëve ne zone.

#### **Gjate ketij viti ne qender te vemendjes do te jene:**

- Perfundimi i rikonstruksionit te Muzeut Arkeologjik të Durrësit
- Muzeut të Pavarësisë në Vlorë;
- Muzeun e Genocidit Komunist ne Shkoder
- Hapjen e Pavionit Etnografik ne Muzeun Historik Kombetar
- Muzeun Arkeologjik te Elbasanit
- Ne partneritet me sektorin privat: Mgritja e Muzeut etnografik te Durresit

- Nisma private: Ngritja e Muzeut ne Kalane e Gjirokastrës, Muzeu ne tunelin e Porto Palermos
- *Ministria po negocion per mundesine e sjelljes se pikturave te piktorit te njohur Lin Delia ne Shqipëri.*

### **Trashegimia Shpirtërore**

- Do te fuqizohet Qendra e Veprimtarive Folklorike dhe Ansambli Popullor
- Do te krijojme nje kalendar aktivitetesh dhe festash tradicionale ne bashkpunim me qeverisjen vendore.

### **Rijetezimi i Monumenteve te Kultures**

- Do te shpallim publikisht nje liste me monumente kulture dhe do te nise procesi i rijetezimit te ketyre objekteve nepermjet perfshirjes se sektorit privat, ne shembullin e nismave qe jane marre ne kalate e Lezhes dhe te Ndroqit.
- Arsyet e kesaj nismme jane:
- Rritja e nivelit te mbrojtjes te monumenteve duke terhequr fonde private
- Kthimin e ketyre monumenteve ne destinacione turistike duke gjeneruar te ardhurave per komunitetet ku ndodhen.
- Përmirësimi i gjendjes së kalave dhe qendrave historike **të Shkodrës Rruga "Kardinal Koliqi", Elbasanit Rruga "Egnatia", të Korçës "Pazari i Vjetër , të Beratit, Kalaja.** përmes (Programi IPA 2009) me vlerën **3,148,262 Euro**

## **7. NË FUSHËN E ARTIT DHE KULTURËS\**

- **Ngritja dhe funksionimi i Qëndres Kombëtare te Artit dhe Kulturës si dhe konsolidimi i Cirkut Kombëtar si nje institucion Qendror i Artit**

### **Kremtimi i 100 vjetorit te Pavaresise**

- Organizimi i veprimtarive festive në **kuadër të vitit jubilar të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.** Duke paraqitur nje kalendarit të pasur te aktiviteteve të MTKRS në bashkërendim me te gjitha Institucionet Publike të Artit si dhe operatorë të tjerë që zhvillojnë veprimtarinë në fushën e artit, kulturës në vend si dhe jashtë saj;
- Ne qender te ketyre aktiviteteve do te jete krijimtaria kombetare.

## 8. NË FUSHËN E LIBRIT DHE BIBLIOTEKAVE

- Aktivitete qe mbeshtesin rrjetin e bibliotekave dhe qe afrojne shkrimtarin me lexuesin. Ne qender te ve, endjes do te jete lexuesi dhe shkrimtari.
- Mbeshtetja e revistave te specializuara ne fushen e kultures duke pasur parasysh mungesen qe ekziston ne kete drejtim.
- Përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor në fushën e librit dhe bibliotekave, i cili do të konsistojnë në futjen e shërbimit të ISSN pranë Bibliotekës Kombëtare.

## 9. FUSHA E RINISË DHE SPORTEVE

### a. Sporti

- Mbështetja e Sporteve Olimpikë me synim përfaqësimin e ekipeve kombëtare në aktivitete kualifikuese dhe ne Lojrat Olimpikë Londer 2012.
- Mbeshtetja e veprimtarive nderkombetare ne vendin tone :
  - **Mbështetja e Kampionatit Botëror të Aeronautikës** i cili do të zhvillohet gjatë muajit maj në Shqipëri;
  - **Mbështetja e Kongresit European të Alpinizmit** i cili do të zhvillohet gjatë muajit Tetor 2012 në Llogara;
  - Mbështetja e elimatoreve të Kampionatit Europain të Basketbollit Meshkuj gjatë muajit Korrik –Shtator 2012;
  - **Mbështetja e elimatoreve të Kampionatit Europain të volejbollit** Meshkuj, gjatë muajit Maj 2012;